

**RREGULLORE NR. 1999/3**

**PËR THEMELIMIN E DOGANËS DHE TË SHËRBIMEVE TË TJERA PËRKATËSE NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën nr. 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregullorën nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë të datës 25 korrik 1999,

Me qëllim të themelimit të doganës dhe të shërbimeve të tjera përkatëse brenda Kosovës dhe në kufijtë ndërkombëtarë të Kosovës,

Shpall sa vijon:

Neni 1

TAKSAT DOGANORE, AKCIZAT DHE TATIMI MBI SHITJEN

1.1 Të gjithë mallrat e çdo lloji të destinuar vetëm për Kosovën, i nënshtrohen tarifës doganore prej dhjetë për qind (10%) për një periudhë tranzitore, me përjashtim të mallrave të regjistruara në Aneksin I\*, për të cilët tarifa doganore është zero.

1.2 Të gjithë mallrat e rigjistruara në Aneksin II, që importohen dhe destinohen vetëm për Kosovën, i nënshtrohen akcizës, siç përcaktohet në atë Aneks. Për arsye administrative, akciza mbledhet në pikat e kalimit kufitar.

1.3 Si masë e përkohshme vendoset tatimi mbi shitjen në masën pesëmbëdhjetë për qind (15%) të vlerës tatimore për të gjithë mallrat e importuar që destinohen vetëm për Kosovën, me përjashtim të mallrave të regjistruara në Aneksin III. Kjo vlerë tatimore llogaritet në pajtim me Nenin 1.4 në vijim.

1.4 Për qëllim të llogaritjes së tatimit mbi shitjen, vlera e të gjithë mallrave të importuar përbëhet nga vlera e përgjithshme doganore, që përfshin taksat doganore dhe akcizën.

1.5 Lista e mallrave, tarifat përkatëse doganore dhe akcizat, si dhe tatimi mbi shitjen, të përcaktuar në Anekset I, II dhe III, i nënshtrohen shqyrtimit periodik.

Neni 2

KUFIZIMET

Kufizimet sasiore të importeve pezullohen me këtë Rregullore deri në një njoftim të dytë.

Neni 3  
DERDHJA E TË ARDHURAVE

Të ardhurat që përfitohen nga tarifat doganore, nga akcizat si dhe nga tatimi mbi shitjen për mallrat e destinuar për Kosovë, derdhen në Buxhetin e Kosovës.

Neni 4  
RREGULLIME ADMINISTRATIVE

4.1 Kjo Rregullore zbatohet, nën kompetencën dhe mbikëqyrjen e plotë të UNMIK-ut, nga nëpunësit e doganës, forcat e policisë dhe të sigurisë si dhe të çdo organi tjetër të caktuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

4.2 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund t'i ftojë nëpunësit e doganës që kanë punuar deri tani në shërbimin doganor të Kosovës për ta vazhduar detyrën e tyre.

4.3 UNMIK-u pranon dhe shqyrton kërkesat e kandidatëve, që kanë kualifikimin e duhur, për të shërbyer në shërbimin doganor.

4.4 Emërimet në shërbimin doganor të Kosovës bëhen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

4.5 Në ushtrimin e funksioneve të tyre, nëpunësit e doganës duhet t'i respektojnë standardet e pranuar ndërkombëtare të përcaktuara në nenin 2 të Rregullores nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999.

Neni 5  
FUSHËVEPRIMI

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm përcakton herë pas here pikat e kalimit kufitar dhe zyrat doganore brenda kufijve të vendit ku ushtrohet kontrolli doganor dhe kryhet zhdoganimi përfundimtar.

Neni 6  
ZBATIMI

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm është i autorizuar të nxjerrë direktiva dhe udhëzime administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 7  
LIGJI NË FUQI

Dispozitat e ligjit në fuqi lidhur me tarifat doganore, akcizat dhe tatimin mbi shitjen në Kosovë zbatohen në përputhje me nenet 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 më sipër.

Neni 8  
HYRJA NË FUQI

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 shtator 1999.

Bernard Kouchner,  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

\* Anekset I, II dhe III i janë bashkëngjitur Urdhresës Administrative nr. 1999/01 të datës 31 gusht 1999